



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 190, datë 22.12.2023

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.4, RRUGA "MUJO ULQINAKU", PALLATI NR.72, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019**

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 202, datë 05.03.2020 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rindërtimit të banesave individuale”, Vendimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit nr.104, datë 08.07.2022, Urdhërit nr. 164, datë 01.07.2020 “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit”, i ndryshuar, të raportit të Komisionit të Posaçëm miratuar nga titullari i institucionit me nr. 11128/1 prot., datë 14.12.2023, si dhe sipas relacionit të hartuar nga ky komision, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**VENDOSI:**

1. Miratimi i listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin nr.72, Njësia Administrative Nr.4, rruga “Mujo Ulqinaku”, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, sipas Aneksit nr.1, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.



Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 22.12.2023**

ANEKSI 1. SUBJEKTET PËRFITUESE TË PALLATIT NR.72, RRUGA "MUJO ULQINAKU"



Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATES	STRUKTURA E APARTAMENTIT QE DO PËRFITOHET
1	JORGO POPLLO, ELENI POPLLO	3	2+1
2	PETRIT TAFI, ZAMAKE TAFI	4	2+1
3	LIRIJE MARTINO, NATASHA BAKRRI	1	1+1
4	ILIR RUPI, EDMONDA MELE, MIRLINDA RUPI, MERITA RUPI	3	2+1
5	ENO KONDURI, IVA KONDURI, MIZIJEN KONDURI, PETRO KONDURI	4	2+1
6	VELI MOLLAJ, ARJOL MOLLAJ	7	3+1
7	REISA MOLLA, SUZANA MOLLA	2	1+1
8	FADIL VORA SHERIJE VORA	4	2+1
9	OSMAN AZIZAJ, SHEFIKAT AZIZAJ	3	2+1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 826/18 prot.

Durrës, më 29.12.2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.190 datë 22.12.2023 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në njësinë administrative nr.4, rruga “Mujo Ulqinaku“, pallati nr.72, i dëmtuar nga fatkeqsia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019“.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një aktadministrativ me karkater individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

